



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
*Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 607/\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË DELVINË “MBI AUDITIMIN  
FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”  
(Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 30.09.2019)**

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Delvinë me objekt “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë”, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Delvinë sipas programit të auditimit nr. 607/1 prot, datë 26.08.2019, për periudhën 01.01.2017 - 30.09.2019.

**II.** Të miratoj Opinionin e Auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## A.OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinion i kualifikuar i auditimit mbi pasqyrat financiare.**

Ne kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Bashkia Delvinë” për vitet ushtrimorë nga 01.01.2017 deri më 30.09.2019, të cilat përfshijnë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2017 dhe 2018. Auditimi përfshin pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve, pagesave*) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimive, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare, mbështetur në standardet (ISSAI 1700)<sup>1</sup>, ISSAI 1705 dhe (ISSAI 1200)<sup>2</sup>.

Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Delvinë, të standardeve mbi raportimin financiar, të kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore, në përgjithësi japin një pamje të drejtë dhe të sinqertë të pozicionit financiar të performancën financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare për Bashkinë Delvinë, për vitin 2017 dhe vitin 2018.

Përrjashtuar disa anomali materiale por jo të përhapura të cilat megjithatë, janë të korigjueshme në periudhat e ardhshme, bazuar në këto, ne arrijmë në përfundimin *për dhënien e një opinionit të kualifikuar.*

Janë konstatuar parregullsi në pasqyrat financiare si vijon:

-Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” me vlerë fillestare 12,203,556 lekë, e analizuar për 38 projekte është mbajtur në bilanc si llogari më vete pavarësisht faktit që këto studime e projektme i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vite dhe duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen në bilanc të Aktiveve Afatgjata Materiale jo në vlerën reale të tyre.

-Llog 4342 “Operacione me shtetin(Të drejta)” në fund të vitit 2018 është raportuar në bilanc në vlerën 35,664,476 lekë, kjo llogari nuk paraqet vlerën e saktë pasi në të janë përfshirë vlerat e llogarisë 401– 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 29,014,013 lekë, vlera të cilat në bilanc duhet të pasqyroheshin në Llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” pra kjo llogari në fund të vitit 2018 duhet të raportohet për vlerën 8,566,685 lekë.

-Ndërsa llogaria 486 “Shpenzimet e periudhave të ardhshme” për vitin 2018 duhej të raportohet në vlerën 33,920,748 lekë.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila në fund të vitit 2018 është paraqitur në vlerën 25,786,192 lekë, nuk paraqet vlerën e saktë, pasi nuk përfshin detyrimet për kontratën nr. 2075, datë 11.09.2018 për objektin “Rikonstruksion i fushës së futbollit të qytetit Delvinë” të faturës tatimore nr. 12, datë 31.10.2018 për vlerën 4,906,735 lekë e cila nuk është kontabilizuar për vitin 2018.

-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është paraqitur më pak për vlerën 1,220,000 lekë, për shkak të mos kontabilizimit të detyrimeve të kontratës nr. s’ka, datë 01.09.2016.

-Në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” pasqyrohet për disa vite rresht, vlera 909,769 lekë, të cilat janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh, të

<sup>1</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>2</sup> Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

cilave ka kaluar afati i garancisë disa për shumë vite.

### **Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimitarisë së Bashkisë Delvinë:**

Ne kemi audituar përputhshmërinë<sup>3/4</sup> e subjektit sa i takon shkallës së zbatimit të ligjeve rregullave dhe rregulloreve, termave apo kushteve të vendosura, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në fushën e prokurimeve publike.

Auditimi ka përfshirë auditimin e 7 procedurave të prokurimit në vitin 2017, të 7 procedurave të prokurimit të zhvilluar në vitin 2018 dhe 7 procedurave të prokurimit të zhvilluara në 9 mujorin e I-të 2019, bazuar në analizë risku<sup>5</sup>.

### **Opinion i kualifikuar**

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të procedurave të prokurimit, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura shumë, me efekt uljen e konkurrencës në procedurat e prokurimeve publike, duke ulur ndjeshëm negativisht këtë konkurrencë.

### **Baza për opinion e kualifikuar**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>6</sup>, për të bazuar opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të disa çështjeve (jo materiale dhe të përhapura), për të cilat duam të tërheqim vëmendjen e subjektit, konkretisht:

U auditua përputhshmëria ligjore në zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për operatorët e shpallur fitues. Në opinionin tonë përsa i përket shkallës së zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi për (*hartimin dhe miratimin e DST kriteret e kërkesave kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave*) në prokurimet publike nga Autoriteti Kontraktor (*bashkia Delvinë*), referuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, duke përjashtuar disa anomali materiale jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar për fushën e zhvillimit të procedurave. Besojmë se evidenca e auditimit që kemi marr janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë si më poshtë;

**a-**Në 21 procedura të audituara, në 5 raste në vlerë totale 26.933.800 lekë pa tvsh, është vrejtur fenomeni “*dorëheqje nga oferta*” e ofertës me vlerë më të ulët, duke ngelë në garë dhe shpallur fitues oferta e OE të vetëm të radhës në klasifikim me vlerë më të lartë se oferta e dorëhequr, ndërkohë që diferencë ndërmjet dy ofertave është disa herë më e lartë se 2% e vlerës së fondit limit të prokuruar që varjon (*nga 2.3% deri 18%*), ndërkohë që procedura e prokurimit duhej të ishte anuluar, veprim i cili mund të sjell dhe përballje me fenomenin e një marrëveshje të fshehtë ndërmjet OE konkurrues, veprim në mospërputhje me pika 5, neni 58 “*Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimin e kontratës*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

**b-**Autoriteti Kontraktor në periudhat raportuese objekt i auditimit (2017; 2018 deri 30.09.2019) me fondet publike ka nxjerr urdhra prokurimi për shpenzime të kryera me

<sup>3</sup> Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së*”.

<sup>4</sup> ISSAI 4100 – *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.*

<sup>5</sup> *Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), Objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.*

<sup>6</sup> *Objektivi i audituesve është të hartojnë dhe kryejnë ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojnë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).*

objekt; blerje mallra, shërbime dhe punë publike objekte të prokuruar me të njëjtën natyrë nëpërmjet procedurës “Vlerë e vogël” me copëzim të fondit publik, duke shmangur procedurat e tjera të prokurimit, ndërsa duhej të kishte prokuruar fondin për këto objekte të grupuara, ose me lote me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondit publik.

**c-**Komisioni Vlerësimit të Ofertave në procedurat e prokurimit të audituara sipas vlerësimit të tij për shpallje fitues të OE konkurrues është mbështetur në përzgjedhjen e procedurës së vlerësimit dhe kriterëve të kërkesave për kualifikim, ndërsa nga auditimi evidentohet se, fokusi i Autoritetit Kontraktor në vlerësimin e ofertave konkurruese është qëndrimi strikt në Dokumentet Standarde të Tenderit në plotësimin e kriterëve të kërkesave për kualifikim, sidomos edhe për ato kritere që mund të trajtohen lehtësisht si devijime të vogla apo shumë të vogla dhe që nuk cenojnë deformimin e vlerës së ofertës e parashikuar nga neni 53, pika 4 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

**d-**Në lidhje me hartimin e miratimit të DST e kriterëve të Kërkesave kualifikuese arrihet në konkluzionin se; Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit, në asnjë rast nuk ka të argumentuar në lidhje me kriteret e vendosura për kërkesat kualifikuese, ndërsa është mjaftuar vetëm me pasqyrimin e përshkrimin e termave të përgjithshme.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Delvinë:**

Drejtimi i Bashkisë Delvinë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator lidhur me raportimin financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe fondet e prokuruar në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit).

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>7</sup>, nëse procedurat e prokurimit publik, nuk paraqesin anomali materiale, si nga ana sasiore dhe cilësore, nëse veprimtaria e subjektit të audituar në fushën e prokurimeve publike, është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me ligjet dhe rregullat, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Delvinë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk është hartuar strategjia e riskut, harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit. Grupi i menaxhimit strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet. Auditimi i brendshëm nuk ka funksionuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Njësia ka në strukturë specialist të IT-së, por nuk janë hartuar rregulla dhe nuk janë marrë masa konkrete për mbrojtjen e të dhënave të

<sup>7</sup> ISSAI 300 Parimet Bazë të Auditimit në lidhje me përputhshmërinë pohojnë se auditimi duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të paligjshme që mund të cenojnë ndjeshëm objektivat e auditimit

sistemit elektronik. Vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është bërë si duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar pikat e dobëta të këtij sistemi, e marrjen e masave për përmirësimin e tyre. Ka mangësi nga stafi për njohjen e ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe manualin përkatës në zbatim të këtij ligji. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nenin 32, të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes vendore” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 28-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Për këtë rekomandojmë:** Titullari i njësisë vendore dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë publike. Të hartohen rregulla për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik. Të hartohet strategjia e riskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

**Në vazhdimësi.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Delvinë nuk ka krijuar Njësi të Auditit të Brendshëm, në kundërshtim me nenin 10 dhe 11, të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe pikën 3, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Komandimi i punonjësve në pozicionin e “Inspektorit të Auditit”, janë bërë në kundërshtim me nenin 48, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke sjell paralizimin e funksionimit të këtij shërbimi tepër të rëndësishëm për realizimin dhe kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësi, gjithashtu ka sjell mungesën e sigurisë objektive dhe mungesën e këshillimit për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Mungesa e këtij shërbimi nuk e ka ndihmuar njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes (*Trajtuar më hollësisht në faqe 30-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Për këtë rekomandojmë:** Titullari i njësisë vendore të marrë masa që funksionimi i Auditit të Brendshëm të organizohet dhe të funksionojë si shërbim në njërin nga tre format e parashikuara në nenin 10 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe pikën 3, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësisë të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

**Në vijimësi.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e pasqyrave financiare konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2017 në llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 35,800,564 lekë. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvritimit të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore, rezulton se me buxhetin e vitit 2018, janë likuiduar detyrime në vlerën 29,654,515 lekë. Për aktivitetin e vitit 2018, gjendja e faturave të pa likuiduara (Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”) paraqitet në vlerën 29,014,013 lekë, për: mallra e shërbime dhe vendime gjyqësore. Nga vlera e detyrimeve si më sipër rezulton se me buxhetin e vitit 2019 është likuiduar shuma prej 23,675,393 lekë, mbetet për likuidim **vlera prej 5,338,620 lekë**, që janë detyrime për fatura për mallra e shërbime në vlerën 2,367,871 lekë dhe shpenzime për Vendime Gjyqate në vlerën 2,970,749 lekë, mos likuidimi i detyrimeve vjen në kundërshtim me nenin 52- Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen

e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësave të Vetëqeverisjes Vendore (Trajtuar më hollësisht në faqe 31-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Delvinë, Drejtoria e Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën **5,338,620 lekë**. Të mos hapen projekte investimesh të reja pa u likuiduar detyrimet e prapambetura.

**Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkisë.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, për vitin 2017, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 331,209 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 289,354 mijë lekë ose në masën 87 %, për vitin 2018, shpenzimet buxhetore në vlerën 296,596 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 278,772 mijë lekë ose në masën 93 % dhe për 9/mujorin e vitit 2019, janë planifikuar në vlerën 205,424 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 183,772 mijë lekë ose në masën 89 %.

U konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu për vitin 2017, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore të planifikuar gjithsej në vlerën 69,615 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë kryer shpenzime sipas realizimit faktik 47,135 mijë lekë duke mos realizuar shpenzimet **në vlerën 22,480 mijë lekë**, për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore të planifikuar gjithsej në vlerën 51,914 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë kryer shpenzime sipas realizimit faktik 29,497 mijë lekë duke mos realizuar shpenzimet **në vlerën 22,417 mijë lekë** dhe për 9/mujorin e vitit 2019, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore të planifikuar gjithsej në vlerën 24,339 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë kryer shpenzime sipas realizimit faktik 21,444 mijë lekë duke mos realizuar shpenzimet **në vlerën 2,895 mijë lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak (*Trajtuar më hollësisht në faqe 31-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Për këtë rekomandojmë:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Delvinë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

**Menjëherë.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i burimit të të ardhurave nga abonentët familjarë nga Bashkia Delvinë rezultojë se, nga 3506 familje që janë në këtë njësi, taksat dhe tarifat vendore planifikohen dhe vilen vetëm nga 2812 familje të cilat kanë kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Sh.a. Delvinë, në cilësinë e agjentit tatimor, ndërsa për **694** familjet që nuk kanë kontratë me UK Delvinë Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk ka dërguar njoftim detyrimi dhe nuk ka planifikuar të ardhura nga këto familje për taksa dhe tarifa. Baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme, veprim dhe mosveprim që bie në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për

Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, dhe VKB për paketën fiskale të vitit 2017,2018,dhe 2019 (Trajtuar më hollësisht në faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Delvinë, nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave, të marrë masa, të nxjerrë njoftim detyrimet për 694 familjet që nuk kanë kontratë me UK Delvinë Sh.a për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për këto familje.

**Në vazhdimësi.**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i listave të subjekteve debitorë në vite, në Bashkinë Delvinë, konstatohen subjekte që aktualisht rezultojnë me status aktiv por me detyrime të pashlyera ndaj Bashkisë Delvinë. Kështu sipas të dhënave nga **245** subjekte debitorë në vlerën **12,841,596** lekë, janë aktiv **74** subjekte ose **30 %** e totalit, të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën **4,503,696** lekë ose **35 %** e vlerës së debitorëve, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të Sektorit të Taksave dhe Tarifave në arkëtimin e detyrimeve debitorë, në kundërshtim të Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar, neni 181-“Mospagimi i taksave dhe tatimeve” (Trajtuar më hollësisht në faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Taksave dhe Tarifave, Bashkia Delvinë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve që rezultojnë me status aktiv dhe që janë debitor ndaj bashkisë për taksa dhe tarifa, në zbatim të Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kodi Penal i RSH, i ndryshuar, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

**Menjëherë.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018, konstatohet se llogaria 202 “Studime dhe projekttime” është mbajtur në bilanc si llogari më vete, duke llogaritur amortizimin për çdo vit pavarësisht faktit që këto studime e projekttime i përkasin investimeve për objekte të përfunduara, me vlerë fillestare prej 12,203,556 lekë, e analizuar për 38 objekte. Rezulton se vlera e këtyre studimeve dhe projekttimeve nuk është sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen e Aktiveve Afatgjata Materiale më pak për vlerën 12,203,556 lekë dhe diferenca në amortizimin e llogaritur, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b” (Trajtuar më hollësisht në, faqe 44-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Për këtë rekomandojmë:** Drejtoria e Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 12,203,556 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara, Aktiveve Afatgjata Materiale si pjesë e kostos së tyre, të sistemohet dhe amortizimi i llogaritur për këto aktive.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019.**

**8. Gjetje nga auditimi: Llog 468 “Debitorë të ndryshëm”** e cila, në fund të 2017 rezulton në vlerën 48,723,862 lekë dhe në fund të vitit 2018 rezultonin në vlerën 48,395,915 lekë me ulje në vlerën 327,947 lekë. Në mënyrë analitike debitorët paraqiten sipas pasqyrës *Aneks C*, bashkëlidhur Raportit të Auditimit. Nga auditimi u konstatua se në llogarinë 468, nuk është përfshirë detyrimi në vlerën **1,220,000 lekë** (për vitin 2017, në vlerën 610,000 lekë dhe për vitin 2018, në vlerën 610,000 lekë për kontratën nr. s’ka, datë 01.09.2016, ku Bashkia Delvinë i jep shoqërisë “DGC” shpk në përdorim sipërfaqen tokës prej 1250 m<sup>2</sup>, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Trajtuar më hollësisht në, faqe 44-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Delvinë, Drejtoria e Financës të marrë masa për kontabilizimin e arkëtimit e detyrimeve në vlerën 1,200,000 lekë të kontratës nr. s'ka, datë 01.09.2016, ku Bashkia Delvinë i jep shoqërisë “DGC” shpk në përdorim sipërfaqen tokës prej 1250 m<sup>2</sup>.

**Deri më 31.03.2020**

**9. Gjetje nga auditimi: Llog 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** e cila, në fund të vitit 2017 dhe vitit 2018 rezulton në vlerën 1,916,222 lekë. Në mënyrë analitike kjo llogari është si më poshtë: Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Sarandë nr. 23-2014-2154(1129), datë 05.06.2015 në vlerën 720,302 lekë dhe Vendimi i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër nr. 22-2017-169/91, datë 07.03.2017, në vlerën 1,145,920 lekë. Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të vitit 2018, për llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” si kundërparti është përdorur llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42 ku përcaktohet se kjo llogari ka si kundërparti llogaritë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 3,227,821 lekë dhe llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 25,786,192 lekë (Trajtuar më hollësisht në, faqe 44-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Delvinë, Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimet e këtyre llogarive me vlerat e tyre reale në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019, për llog. 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”, për vlerën 8,566,685 lekë, llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, për vlerën 33,920,748 lekë, llog. 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, për vlerën 3,227,821 lekë dhe llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për vlerën 30,692,927 lekë.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019.**

**10. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 8,590,291 lekë dhe në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 10,568,767 lekë, pra ka një rritje prej 1,978,476 lekë. Këto vlera janë paraqitur në mënyrë analitike dhe përbëhen nga: 5% fondi i garancisë për punime dhe shërbimet për kontrata të ndryshme me subjektet. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se, vlera prej 909,769 lekë përfaqëson detyrime të bashkisë ndaj subjekteve, për garanci punimesh të kryera para vitit 2016, paraqitur analitikisht sipas pasqyrës Aneks C, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Trajtuar më hollësisht në, faqe 44-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Për këtë rekomandojmë:** Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Sektorin e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

**Menjëherë e vazhdimisht.**

**11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 30,546,961 lekë dhe në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 25,786,192 lekë, pra ka një ulje prej 4,760,769 lekë. Këto vlera janë paraqitur në mënyrë analitike dhe përbëhen nga Fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore. Nga auditimi rezulton se **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”**, e cila në fund të vitit 2018 është paraqitur në vlerën 25,786,192 lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara, është paraqitur më pak për vlerën **4,906,735 lekë** vlerë e



cila i përket faturës tatimore nr. 12, datë 31.10.2018 e cila është likuiduar me urdhër shpenzimi nr. 186, datë 25.04.2019, për kontratën nr. 2075, datë 11.09.2018 për objektin **“Rikonstrukcion i fushës së futbollit të qytetit Delvinë”**, kjo faturë nuk është kontabilizuar për vitin 2018, duke paraqitur më pak llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2018, në vlerën **4,906,735 lekë**, veprim në papajtueshmëri me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësite e qeverisjes së përgjithshme”* pika 42” (Trajtuar më hollësisht në, faqe 44-50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Për këtë rekomandojmë:** Drejtoria e Financës në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

**Në vijimësi.**

**12. Gjetje nga auditimi:** Në 9 (nëntë) raste me vlerë 45,329,835 lekë, KVO nuk ka kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomik, vlera e të cilave është më e ulët se ofertat fituese, por me devijime të vogla nuk kanë plotësuar kriteret e kërkesave kualifikuese të vendosura në DST, megjithatë KVO ka shpallur fituese edhe ofertat e operatorëve ekonomik të cilat po me devijime shumë të vogla që nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese, ndërsa KVO duhej të kishte anuluar procedurën e prokurimit për mungesë konkurrence, pasi në garë nuk ngelet asnjë ofertë e vlefshme veprim në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, neni 46 *“Kualifikimi i ofertuesve”* pika 1, neni 53 *“Shqyrtimi i ofertave”*, në VKM nr. 914, datë 29.02.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Kreu (VIII) *“Kushte të përgjithshme për zbatim”*, neni 73 *“Mungesa e konkurrencës”* (Trajtuar më hollësisht në faqe 50-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Për këtë rekomandojmë:** Titullari Autoritetit Kontraktor i njësisë vendore (bashkia Delvinë) të analizojë kualifikimin e OE me vlerë oferte më të ulët të cilat për devijime shumë të vogla nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese në procedurat e analizuara mësipërm duke nxjerrë përgjegjësi edhe marr ne konsideratë faktin, se janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik po me devijime shumë të vogla që nuk plotësojnë kriteret e DST, të cilat kanë risk dhe nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të kontratës.

**Menjëherë.**

**13. Gjetje nga auditimi:** Në 7 (shtatë) raste Njësia e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit në procesverbalin e mbajtur për hartimin e miratimin e DST, nuk ka argumentuar në asnjë rast në lidhje me kriteret e vendosura për secilën nga kërkesat e veçanta të kualifikimit, ndërsa është mjaftuar vetëm me pasqyrimin e përshtimit të termave në mënyrë të përgjithshme, apo janë vendosur kriteret kualifikuese të pa nevojshme e të ekzagjeruar, veprim në mospërputhje me neni 26 *“Kontratat për punë publike”*, pika (5), neni 46 *“Kualifikimi i ofertuesve”* pika 1, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, neni 61 *“Hartimi dhe publikimi dokumenteve të tenderit”* pika (1); (2), paragrafi (2) dhe neni 1, 2, 20, 23 dhe pikat (1) e (3) neni 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 50-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Për këtë rekomandojmë:** Njësia e Prokurimit në hartimin dhe miratimin e kriterëve të kërkesave kualifikuese në DST, të jap argumente të hollësishme për secilin kriter kualifikues të cilat të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj. Argumentimi të bëhet bazuar në natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave të manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, licencave, me analizë të hollësishme për secilin kriter të vendosur.

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës me objekt “Rehabilitimi i pjesshëm i kanalit ujitës K-K-5 Bajkaj” Bashkia Delvinë, mbi verifikimin në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me kryerjen e zërave të punimeve sipas preventivit të ripunuar si dhe volumet e punës të situacionuara, rezultoi se, investimi nuk është funksional për shkak të dëmeve të shkaktuara si pasojë e reshjeve të shumta në periudhën kohore 01.02.2018 deri 04.02.2018 të shkaktuara në kanal in ujitës K-K-5, nga dalja e shtratit të Lumit Kalasë dhe se vepra e ndërtimit është plotësisht jashtë funksionit për realizimin e objektivit kryesor për ujitjen e tokave bujqësore. Nga llogaritja e bërë për dëmet e shkaktuara pas reshjeve të shiut, që sollën shkatërrimin e veprës së marrjes dhe 60 ml argjinaturë, rezulton një dëm në vlerën 2,131,800 lekë pa TVSH (Trajtuar më hollësisht në faqe 85-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Delvinë, për rastin konkret, si dhe në vazhdimësi për projektet e zbatimit me të njëjtin objektiv dhe me të njëjtën detyrë projektimi të veprave ndërtimore ujitëse, të sigurohet për garancinë e projektit nga institucione kompetente dhe në vijim të kryejë miratimin e projektit të zbatimit, duke garantuar cilësi dhe qëndrueshmëri të lartë në implementim me eficiencë të veprave ujitëse bujqësore.

Në vazhdimësi.

**15. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Delvinë është audituar nga KLSH në vitin 2017 dhe vijim është bërë verifikimi zbatimit të rekomandimeve të dërguara në bashki nga KLSH. Me shkresë nr. 490/22, datë 03.08.2018 është rikërkuar zbatimi masave të pa zbatuara dhe për përmirësimin e gjendjes janë rikërkuar;

-Për masa organizative, janë rekomanduar 15 masa të pranuar plotësisht, nga të cilat 7 masa janë zbatuar, ndërsa 8 masa janë në proces zbatimi.

-Për shpërblim dëmi janë rikërkuar për zbatim 10 masa me vlerë 39.075.744 lekë, nga e cila është pranuar dhe kontabilizuar vlera 39.075.744 lekë, ndërsa nuk është pranuar dhe nuk është kontabilizuar 1 masë në vlerë 4.836.825 lekë dhe deri në datë 30.09.2019 është arkëtuar vetëm vlera 649,144 lekë, ku shuma prej 33.589.775 lekë nuk rezulton e arkëtuar.

-Për masa disiplinore, janë rekomanduar 8 masa të cilat janë zbatuar plotësisht, ndërsa nuk ka procese gjyqësore në lidhje me masat e rekomanduara (Trajtuar më hollësisht në faqe 88-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Për këtë rekomandojmë:** Nga Titullari i Bashkia Delvinë të analizohen dhe të nxirren përgjegjësitë për mos zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm dhe në vijim të merren masa të menjëhershme për zbatimin e tyre deri në hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e dëmit. Për këtë nga titullari të hartohet plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij.

Menjëherë.

### **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,875,822 lekë** si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rijetësimi i sheshit të qendrës Delvinë*”, Bashkia Delvinë, me vlerë të kontratës (me tvsh)

130,059,734 lekë, fituar nga OE "GP" shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 2,310,600 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2303 prot datë 27.09.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Delvinë dhe OE "GP" shpk (*Trajtuar më hollësisht në faqe 80-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Për këtë rekomandojmë:** Nga Bashkia Delvinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,310,600 lekë pa tvsh** nga OE "GP" shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 2303 prot datë 27.09.2016, me objekt "Rijetësimi i sheshit të qendrës Delvinë", Bashkia Delvinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "**Rehabilitim i pjesshëm i kanalit ujitës K-K-5 Bajkaj- Delvinë (vazhdim)**", Bashkia Delvinë, me vlerë të kontratës (me tvsh) 7,639,999 lekë, fituar nga OE "M." shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **113,600 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve 2053 prot datë 12.12.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Delvinë dhe OE "M." shpk (*Trajtuar më hollësisht në faqe 80-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Për këtë rekomandojmë:** Nga Bashkia Delvinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **113,600 lekë pa tvsh** nga OE "M." Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me 2053 prot datë 12.12.2017, me objekt "Rehabilitim i pjesshëm i kanalit ujitës K-K-5 Bajkaj- Delvinë (vazhdim)", Bashkia Delvinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit të kontratës nr. 1349, datë 30.05.2019, me vlerë 14,549,220 lekë (me TVSH), në objektin "Sistemim rruge të brendshme në fshatrat Shijan, Stjar e Bamatat", Bashkia Delvinë u konstatuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në vlerën **301,800 lekë**, nga zbatuesi i punimeve Operatori Ekonomik (OE) "LT" shpk, për zërin e punimeve "*Shtresë çaklli i fraksionuar t=12 cm, b=2\*0.5 m për bankinat anës shtresës së betonit*" përkatësisht për rrugët e fshatrave: Blerimas, Bamatat, Stjar, Unaza e fshatit Stjar dhe Sistemimi i rrugës Rilindja. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas kontratës me Nr. 1349 Prot, datë 30.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Delvinë dhe Operatorit Ekonomikë "LT" shpk. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 85-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Për këtë rekomandojmë:** Të merren masa nga Bashkia Delvinë, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Operatorit Ekonomikë "LT" shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **301,800 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nëpërmjet një proces verbali të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Delvinë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike të parashikuara në Dokumentet e Tenderit (DT), do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

**Menjëherë.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në objektin "Rehabilitimi i pjesshëm i kanalit ujitës K-K-5 Bajkaj" Bashkia Delvinë, nga zbatuesi i punimeve Operatori Ekonomik "B" shpk u konstatuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në vlerën **149,822 lekë pa TVSH**, për zërat e punimeve: Zëri 5 (3.206) Shtresë zhavorri natyral ose mbeturinë gurore me kokrrizë max. deri në 30 mm për seksion;

Zëri 6 (3.158/5a ) Transport zhavorri natyral me auto deri në 10 km; Zëri 23 (3.243) Betone për Vepra arti C 12/15 (M-150), sipas kontratës me Nr. 769 Prot, datë 28.04.2017 me vlerë 14,882,094 lekë me TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas kontratës me Nr. 769 Prot, datë 28.04.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Delvinë dhe Operatorit Ekonomikë “B”shpk (*Trajtuar më hollësisht në faqe 85-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Për këtë rekomandojmë:** Nga Bashkia Delvinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **149,822 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomikë “B” shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 769 Prot, datë 28.04.2017 me objekt “Rehabilitimi i pjesëshëm i kanalit ujis K-K-5 Bajkaj”, Bashkia Delvinë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë.**

## **C/I. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave dhe Tarifave, Bashkia Delvinë, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej **debitorë 245 subjekte për vlerën 12,841,596 lekë dhe 2090 familje për vlerën gjithsej 41,026,049 lekë** (për taksë toke në vlerën 31,342,463 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 3,593,993 lekë, dhe tarifa shërbimi në vlerën 6,089,233 lekë.

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimin, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-“*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet (*Trajtuar më hollësisht në faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Taksave dhe Tarifave, Bashkia Delvinë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura **për 245 subjekte për vlerën 12,841,596 lekë dhe 2090 familje për vlerën gjithsej 41,026,049 lekë** (*sipas pasqyrave që disponon, dërguar me E-mail*), bazuar në nenin 70 pika 3 “*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-*T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

b-*Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.*

c- *Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

d- *Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

**Menjëherë.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, Bashkia Delvinë, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **100 persona me vlerë 3,760,691 lekë**, për periudhën 01.01.2017–30.09.2019, të cilat përbejnë të ardhura të munguara për **Buxhetin e Bashkisë Delvinë** sipas pasqyrës Aneks B/18 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Delvinë, nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave, të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **3,760,691 lekë**

**Menjëherë.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i akt rakordimeve me agjentin tatimor Ujësjetllës Kanalizim Sh.a Delvinë, rezultoi se deri në 30.09.2019, nga të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat për llogari të Bashkisë Delvinë në vlerën 3.742.676 lekë, ka derdhur në buxhetin e bashkisë vetëm vlerën prej 1.714.706, me një diferencë prej 2.027.970 lekë. Sektori i Taksave dhe Tarifave në kërkim të arkëtimit të gjithë shumës së mbledhur nga agjentët tatimor, si dhe në zbatim të nenit 117, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka aplikuar penalitetet ndaj agjentit tatimor Ujësjetllës Kanalizime Sha, Delvinë, për faktin se nuk ka derdhur në buxhetin e bashkisë vlerën prej **2,027,970 lekë** nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore, **shumë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë** (*Trajtuar më hollësisht në faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Taksave dhe Tarifave, Bashkia Delvinë, të marrë masa për detyrimin e agjentit tatimor UK Sh.a. Delvinë për derdhjen në buxhetin e bashkisë të vlerës prej **2,027,970 lekë**, duke aplikuar penalitetet e parashikuara në nenin 117, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

**Menjëherë.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i praktikave të pajisjes me Autorizim/Licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, u konstatua se nga Zyra e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave për vitet 2017 - 2019, ndaj subjekteve “M” shpk, “K”, me NIUS dhe “K”, nuk është aplikuar saktë tarifa vendore për pajisjen e subjekteve, me Autorizim/Licenca në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, **e cila ka sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Delvinë, në vlerën 2.700,000 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Për këtë rekomandojmë:** Zyra e Shërbimeve Publike dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Delvinë, të marrin masa për arkëtimin e vlerës 2.700.000 lekë, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, si më poshtë:

- “M”, për vlerën 900.000 lekë,
- “K”, për vlerën 900.000 lekë,
- “K”, shpk, për vlerën 900.000 lekë.

**Menjëherë.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Delvinë, nuk ka bërë të mundur arkëtimeve të detyrimeve të qirasë për kontratën nr. s'ka, datë 01.09.2016, për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqes së tokës prej 1250 m<sup>2</sup> subjektit “DGC”shpk, **në vlerën gjithsej 1,830,000 lekë**, (viti 2017, në vlerën 610,000 lekë, viti 2018, në vlerën 610,000 lekë dhe viti 2019, në vlerën 610,000 lekë) e cila përbën mungesë të ardhurash për **buxhetin e Bashkisë**, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 7850, datë 29.07. 1994 “Për Kodin Civil në RSH”, nenin 12, germa “g”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” me pikën 2, neni 6, i kontratës datë 01.09.2016 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1. Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori Juridik, Bashkia Delvinë të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktore në vlerën **1,830,000 lekë**.

**Menjëherë.**

**6. Gjetje nga auditimi:** Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës Bujqësore, Bashkia Delvinë, për 66 kontrata për sipërfaqe 104.85 ha në vlerën gjithsej 661,363 lekë, nuk ka bërë të mundur arkëtimeve të detyrimeve të qirasë për 3 kontrata, në **vlerën gjithsej 172,088 lekë**, sipas viteve (viti 2013-2016, në vlerën 57,527 lekë, viti 2017, në vlerën 57,281 lekë dhe viti 2018, në vlerën 57,281 lekë) për kontratat me: z. L.K, për kontratën datë 01.10.2013, për shfrytëzimin e sipërfaqes prej 1.5 ha, në vlerën 57,527 lekë, N.B, për kontratën datë 25.10.2013, lidhur me Bashkinë Delvinë për shfrytëzimin e sipërfaqes prej 1.98 ha, për vlerën 50,621 lekë dhe A.B, për kontratën datë 17.10.2013, për shfrytëzimin e sipërfaqes prej 2.5 ha, për vlerën 63,940 lekë e cila përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” nenin 12, germa “g”, me nenin 2, germa “a” e kontratave të lidhura mes Bashkisë Delvinë dhe Qiramarrësve të tokave bujqësore të pandara (*Trajtuar më hollësisht në faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës Bujqësore dhe Sektori Juridik, Bashkia Delvinë të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktore në vlerën **172,088 lekë**.

**Menjëherë.**

## **C/II. SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUNDËRSHTIM ME KËRKESAT LIGJORE TË PROKURIMIT DHE EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

Në 5 raste në vlerë totale 26.933.800 lekë pa tvsh, është vërejtur fenomeni “*dorëheqje nga oferta*” e ofertës me vlerë më të ulët, duke ngelë në garë dhe shpallur fitues oferta e OE të vetëm të radhës në klasifikim me vlerë më të lartë se oferta e dorëhequr, ndërkohë që diferencë ndërmjet dy ofertave është disa herë më e lartë se 2% e vlerës së fondit limit të prokuruar që varjon (*nga 2.3% deri 18%*), ndërkohë që procedura e prokurimit duhej të ishte anuluar, veprim i cili mund të sjell dhe përballje me fenomenin e një marrëveshje të fshehtë ndërmjet OE konkurrues, veprim në mospërputhje me pika 5, neni 58 “*Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimin e kontratës*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, në mënyrë të detajuar si më poshtë:

**1.1. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “*Rehabilitim kanal ujitës Bajkaj, Delvinë (vazhdim)*”, zhvilluar në datën 13.11.2017, me fond limit 7.466.666 lekë pa tvsh, kanë marr pjesë 4 OE të kualifikuar në kriteret e vendosura në DST, ndërsa KVO ka shpall fitues ofertën e OE “M/S” me vlerë të ofertës 6.366.666 lekë pa tvsh, pasi oferta e OE “N” nuk është pranuar me argument se, ky operator ka depozituar deklaratë “*dorëheqje nga oferta*” e nënshkruar nga administratori me vulën e shoqërisë. Në këto kushte KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit për arsye se, oferta e renditur e dyta e shpallur fituese, është me diferencë ndërmjet

dy ofertave në shumën 1,412,236 lekë pa tvsh, disa herë me e lartë se (2%) e vlerës fondit limit konkretisht (18%). Për pasojë vlerësimi e përzgjedhja e ofertës fituese si dhe lidhja e kontratës me shoqërinë në vlerë 6,366,666 lekë pa tvsh konsiderohet përdorim i fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, veprim në mos përrputhje me neni 58 “Njoftimi fituesit dhe nënshkrimi kontratës”, pika (5), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 50-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.2. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “Sistemim pjesshëm rruga fshatrat Lefterhor, Kakodhiq, Sopot”, zhvilluar në datën 11.04.2018, me fond limit 2,500,000 lekë pa tvsh, kanë marr pjesë 2 OE të kualifikuar në kriteret e vendosura në DST, ndërsa KVO ka shpall fitues ofertën e BOE “E&I” me vlerë të ofertës 2,471,255 lekë pa tvsh, pasi oferta e OE “M/S” nuk është pranuar me argument se, ky operator ka depozituar deklaratë “dorëheqje nga oferta” e nënshkruar nga administratori me vulën e shoqërisë. Në këto kushte KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit për arsye se, oferta e renditur e dyta e shpallur fituese, është me diferencë ndërmjet dy ofertave në shumën 120,755 lekë pa tvsh, disa herë me e lartë se (2%) e vlerës fondit limit konkretisht (5%). Për pasojë vlerësimi e përzgjedhja e ofertës fituese si dhe lidhja e kontratës me shoqërinë në vlerë 2,471,255 lekë pa tvsh konsiderohet përdorim i fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, veprim në mospërrputhje me neni 58 “Njoftimi fituesit dhe nënshkrimi kontratës”, pika (5), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 50-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.3. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i fushës së futbollit të qytetit Delvinë”, zhvilluar në datën 14.0.2018, me fond limit 7,388,195 lekë pa tvsh, kanë marr pjesë 2 OE të kualifikuar në kriteret e vendosura në DST, ndërsa KVO ka shpall fitues ofertën e BOE “LT&B&V” me vlerë të ofertës 6,964,094 lekë pa tvsh, pasi oferta e OE “SH” nuk është pranuar me argument se, ky operator ka depozituar deklaratë “dorëheqje nga oferta” e nënshkruar nga administratori me vulën e shoqërisë. Në këto kushte KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit për arsye se, oferta e renditur e dyta e shpallur fituese, është me diferencë ndërmjet dy ofertave në shumën 871,519 lekë pa tvsh, disa herë me e lartë se (2%) e vlerës fondit limit konkretisht (11.7%). Për pasojë vlerësimi e përzgjedhja e ofertës fituese si dhe lidhja e kontratës me shoqërinë në vlerë 6,964,094 lekë pa tvsh konsiderohet përdorim i fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, veprim në mospërrputhje me neni 58 “Njoftimi fituesit dhe nënshkrimi kontratës”, pika (5), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 50-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.4. Gjetje nga auditimi:** Në tenderi e zhvilluar me objekt “Sistemim rrugë brendshme në fshatrat Fushveri, Vergo, Palavli” me fond limit 5,116,666 lekë pa tvsh, kanë marr pjesë 2 OE të kualifikuar në kriteret e vendosura në DST, ndërsa KVO ka shpall fitues ofertën e OE “I” me vlerë të ofertës 5,022,555 lekë pa tvsh, pasi oferta e OE “M/S” nuk është pranuar me argument se, ky operator ka depozituar deklaratë “dorëheqje nga oferta” e nënshkruar nga administratori me vulën e shoqërisë. Në këto kushte KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit për arsye se, oferta e renditur e dyta e shpallur fituese, është me diferencë ndërmjet dy ofertave në shumën 337.855 lekë pa tvsh, disa herë me e lartë se (2%) e vlerës fondit limit konkretisht (6.6%). Për pasojë vlerësimi e përzgjedhja e ofertës fituese si dhe lidhja e kontratës me shoqërinë në vlerë 5,022,555 lekë pa tvsh konsiderohet përdorim i fondit publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, veprim në mospërrputhje me neni 58 “Njoftimi fituesit dhe nënshkrimi kontratës”, pika (5), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 50-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.5. Gjetje nga auditimi:** Në tenderi e zhvilluar me objekt “Sistemim rrugë brendshme fshatra Bajkaj, Kopaçe, Isaki” me fond limit 6,252,500 lekë pa tvsh, kanë marr pjesë 2 OE të kualifikuar në kriteret e vendosura në DST, ndërsa KVO ka shpall fitues ofertën e BOE “I&E” me vlerë të ofertës 6,109,230 lekë pa tvsh, pasi oferta e OE “M/S” nuk është pranuar me

argument se, ky operator ka depozituar deklaratë “*dorëheqje nga oferta*” e nënshkruar nga administratori me vulën e shoqërisë. Në këto kushte KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit për arsye se, oferta e renditur e dyta e shpallur fituese, është me diferencë ndërmjet dy ofertave në shumën *132,630 lekë pa tvsh* më e lartë se (2%) e vlerës fondit limit konkretisht (2.3%). Për pasojë vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertës fituese dhe lidhja e kontratës me shoqërinë në vlerë 6,109,230 lekë pa tvsh konsiderohet përdorim i fondit publik ***pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet***, veprim në mospërputhje me neni 58 “*Njoftimi fituesit dhe nënshkrimi kontratës*”, pika (5), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqe 50-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për këtë rekomandojmë:** Titullari Autoritetit Kontraktor të njësisë vendore (*bashkia Delvinë*), të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e mësipërme me qëllim që në të ardhmen të eliminohen rastet e kualifikimit të ofertave të renditura pas ofertës së OE për të cilat nga KVO është pranuar deklarata “*dorëheqje nga oferta*”, ndërkohë që diferencat ndërmjet dy ofertave janë disa herë më të larta se (2%) e vlerës së fondit limit të prokuruar, veprime të cilat kanë sjellë pasojë dhe kanë dhënë impakt në përdorimin e fondit publik me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në **vlerë totale 26,933,800 lekë pa tvsh në (5 rastet)**. KVO duhet të udhëhiqet nga zbatimi kriterëve të parashikuara nga ligji për prokurimet publike me qëllim sigurimin me eficientë maksimale të fondit dhe dhënie përparësi ofertës me vlerë më të ulët, si kriteri bazë i parashikuar në kriteret e vendosura në DST.

**Menjëherë.**

#### **D. MASA ADMINISTRATIVE:**

##### **D/1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) bashkia Delvinë.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Delvinë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative (gjobë) për një mbikëqyrës punimesh**, si më poshtë:

**1. 50,000 lekë për z. R.S.** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektet “*Rijetësimi i sheshit të qendrës Delvinë*”, *Bashkia Delvinë*, me sipërmarrës punimesh OE “GP”, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **2,310,600 lekë pa tvsh**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

#### **E. MASA DISIPLINORE:**

##### **E/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të nenit 58, “*Ilojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Delvinë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për **8 (tetë) punonjës**, si më poshtë:

**a. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (c), për 8 punonjësit si më poshtë:**



1. **Z. F.A**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave;
2. **Znj. Z.K**, me detyrë Inspektore në Sektorin e Taksave dhe Tarifave;
3. **Znj. I. B**, me detyrë Inspektore në Sektorin e Taksave dhe Tarifave,
4. **Znj. E.T**, me detyrë Inspektore në Sektorin e Taksave dhe Tarifave.

Për mos përmbushje të detyrave në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, si më poshtë:

-Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, të ligjit nr 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB për paketën fiskale, duke mos realizuar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore për 245 subjekte për vlerën 12.841.596 lekë të biznesit të madh e të vogël 12.841.596 lekë , dhe për 2090 familje për vlerën 41.026.049 lekë

-Për moszbatim të kërkesave të nenit 20 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, dhe VKB për paketën fiskale të vitit 2017,2018,dhe 2019, për 694 familje nuk ka dërguar njoftim detyrimi dhe nuk ka planifikuar të ardhura prej këtyre familjeve për taksa dhe tarifa vendore.

- Për mos zbatim të kërkesave të nenit 117, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka aplikuar penalitetet ndaj agjentit tatimor Ujësjellës Kanalizime Sha, Delvinë, për faktin se nuk ka derdhur në buxhetin e bashkisë vlerën prej 2.027.970 lekë nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore,

- Për mos zbatim të kërkesave të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 100 persona me vlerë 3.760.691 lekë, për periudhën 01.01.2017 – 30.09.2019.

-Për mos zbatimin e kërkesave të kapitullit të II, pika 1; e shkronjës “b”, si dhe të pikës 9, të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar. Nga mos aplikimi i saktë i tarifës për pajisjen me Autorizim/Licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante, dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, Bashkisë Delvinë i janë shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 2.700,000 lekë.

5. **Z. K.M**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit Urban për mos përmbushje të detyrave në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, si më poshtë:

- Për mos zbatim të kërkesave të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 100 persona me vlerë 3.760.691 lekë, për periudhën 01.01.2017 – 30.09.2019

6. **Z. O.R**, me detyrë Specialist i Transportit dhe Infrastrukturës për mos përmbushje të detyrave në pajisjen me licenca të subjekteve, si më poshtë:

-Për mos zbatimin e kërkesave të kapitullit të II, pika 1; e shkronjës “b”, si dhe të pikës 9, të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar. Nga mos aplikimi i saktë i tarifës për pajisjen me Autorizim/Licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante, dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, Bashkisë Delvinë i janë shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 2.700,000 lekë.

7. **Znj. L.J**, me detyrë Drejtore e Financës, për mos zbatim të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për paraqitjen e të dhënave në pasqyrat financiare, në zbatimin e kërkesave të UMF 14

dt 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”; ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 7, 9, 10; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**8. Z. M.T**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore, mos ndjekja e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve të kontratave për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara, në vlerën 172,088 lekë, në, papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” nenin 12, germa “g”, me nenin 2, germa “a” e kontratave të lidhura mes Bashkisë Delvinë dhe Qiramarrësve të tokave bujqësore të pandara.

### **E/2 Në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë:**

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit nga 7 punonjësit e mëposhtëm, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Delvinë, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019 të marrë masat e nevojshme disiplinore për **7 punonjësit si më poshtë:**

Për 4 anëtarë të Njesisë së Prokurimit, njëkohësisht hartues të DST, si më poshtë vijon:

**1-B.K** me detyrë Jurist i bashkisë,

**2-E.I** me detyrë specialiste e protokollit,

**3-E.S** me detyrë specialiste e arkivës,

**4-Y.A** me detyrë specialist në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban.

Për mos kryerjen e detyrave në fushën e prokurimeve publike, në procedurat e realizuara Njësia e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit në procesverbalet e mbajtur për hartimin e miratimit të DST, nuk ka argumentuar në asnjë rast kriteret e vendosura për secilën nga kërkesat e veçanta të kualifikimit, ndërsa është mjaftuar vetëm me pasqyrimin e përshkrimit të termave në mënyrë të përgjithshme, apo janë vendosur kriteret kualifikuese të pa nevojshme e të ekzagjeruar. mospërputhje me neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika (5), nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 61 “Hartimi dhe publikimi dokumenteve të tenderit” pika (1); (2), paragrafi (2) dhe neni 1, 2, 20, 23 dhe pikat (1) e (3) neni 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në drejtim të hartimit e miratimit të DST dhe vendosjen e kriterëve të kërkesave kualifikuese.

-Për 3 anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

**5-L.R** me detyrë specialiste e financës,

**6-O. R** me detyrë specialist në sektorin e shërbimeve,

**7-A.A** me detyrë Kryeinspektor i IMT<sup>së</sup>.

Për mos kryerjen e detyrave në fushën e prokurimeve publike, sepse në zbatimin e procedurave të prokurimit në 5 raste kanë shpallur fituese ofertat e OE të radhës të mbetura në klasifikim me vlerë më të lartë se vlera e ofertës së OE të cilit i është pranuar deklarata “dorëheqje nga oferta”, ndërkohë që diferencë ndërmjet dy ofertave është disa herë më e lartë se 2% e vlerës së fondit limit të prokuruar (nga 2.3% deri në 18%), duke sjellë efekte financiare negative në buxhet me pasojë përdorimin e fondit publik pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për vlerën 26,93,800 lekë pa tvsh, njëkohësisht në 9 raste KVO nuk ka kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomik, vlera e të cilave është më e ulët se oferta fituese me devijime të vogla që nuk kanë plotësuar kriteret e kërkesave kualifikuese të vendosura në DST, duke shpallur fituese edhe oferta të operatorëve ekonomik të cilat po me devijime shumë të vogla nuk i plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese, ndërsa procedura e prokurimit duhej të ishte

anular për mungesë konkurrence, pasi në garë nuk ngelet asnjë ofertë e vlefshme në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, në VKM nr. 914, datë 29.02.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu (VIII) “Kushte të përgjithshme për zbatim”, neni 73 “Mungesa e konkurrencës”, veprim në mospërputhje me pikën (5), neni 58 “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimin e kontratës”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruar në Raportit Përfundimtar të Auditimit, në drejtim të vlerësimit e kualifikimit të Ofertave Ekonomike Konkurruese.

*\*Shënim:* Për punonjësit: I.M, me detyrë ish/nën Kryetar i bashkisë, në cilësinë anëtare e KVO<sup>së</sup>, znj.E.Z, me detyrë ish/Shefe Kabineti, në cilësinë anëtare e Njësisë së Hartimit të DST, E.N, me detyrë ish/Specialiste e financës, në cilësinë anëtare e Njësisë së Hartimit të DST, R.A me detyrë ish/Specialiste në sektori planifikimit dhe zhvillimit urban, në cilësinë anëtare e Njësisë së Hartimit të DST dhe M.D ish/Specialiste në sektori planifikimit dhe zhvillimit urban, në cilësinë anëtare e KVO<sup>së</sup> nuk mund të rekomandojmë masa disiplinore megjithëse mangësitë e shkeljet e konstatuara ekzistojnë dhe janë të natyrës administrative, ndërsa nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat janë të larguar nga detyra.

## **F. SHËNIM I KRYETARIT**

Pavarësisht përpjekjeve të Grupit të auditimit, Programi i auditimit nuk është realizuar në përputhje me objektivat e auditimit. Problematikat e trajtuara duhet të ishin trajtuar më në thellësi në analiza mbështetur në gjetjet dhe duhet të ishte trajtim i plotë i të gjitha pikave të Programit. Disa procedura prokurimi Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore ti planifikojë ti auditojë përsëri gjatë vitit 2020 (me këtë grup auditimi të jetë dhe Drejtoria Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë), ose në auditimin e radhës, pasi grupi ka patur kufizime në kohë dhe në numër audituesish (vetëm tre).

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**